



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog
Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istog

Komititet për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

Nr. 40	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e Rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	21.05.2025 në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Enver Rugova, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut
Procesmbajtës:	Flora Bujupaj Asistente Administrative pranë Zyrës së Kryesuesit të Kuvendit
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Hajrush Shoshi, Liridona Lajçi, Faruk Kabashi, Ardita Idriza Ajshe Metaj dhe Arian Shatri.
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjerë:	Kryetari i Komunës Ilir Ferati, Drejtorët: Genc Ademaj, Abedin Kabashi, Vlora Vuthaj, Naim Behlulaj, zyrtar administrativ: Ardon Arifaj, Liliana Frrokaj, Jeta Balaj.
Rendi i ditës:	
<ol style="list-style-type: none">1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,2. Njoftimi me Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028,3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Tregun tërë ditë në Istog,4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale.	
Diskutimet:	
<p>Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova -përshëndeti të pranishmit. Konstaton se të pranishëm janë 7 anëtarë të KPF-së prezent, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e mbledhjes. Hapi punimet për këtë mbledhje me këtë rend dite. Prezanton rendin e ditës, Fton ekzekutivin si dhe anëtarët e KPF-së nëse dikush ka ndonjë pyetje sugjerim apo ndonjë propozim për rend dite?</p> <p>Kryesuesi i Kuvendit- përshëndet të gjithë! Sa i përket pikës tre të rendit të ditës është mbajtur dëgjim publik, mirëpo komplet materialin nuk është përgatitur dhe kisha propozuar këtë pikë ta heqim nga rendi</p>	

ditës. Pyes ekzekutivin dhe ju anëtarë të KPF-së, a ka vërejtje apo ndonjë propozim të ri. Fjalën e ka drejtori Kadastrës Agon Dreshaj.

Agon Dreshaj- propozoj një pikë të re të rendit të ditës ' Destinimi i parcelës për varrezat e fshatit Zhakovë. Është kërkesë nga një qytetar, i cili ka bashkëngjitur edhe një peticion me nënshkrime të bashkëfshatarëve.

Kryesuesi i Kuvendit- pyes ekzekutivin a ka ndonjë propozim apo diçka tjetër rreth rendit të ditës? Drejtori Abedin Kabashi e ka fjalën.

Abedin Kabashi- propozon një pikë të rendit të ditës "Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit, Pejë, Klinë,Istog, Deçan dhe Junik 2025-2035.

Kryesuesi i Kuvendit- A ka edhe dikush diçka? Fjalën e ka Genc Ademaj.

Genc Ademaj- pika që propozoj që të hyn në rend dite është 'Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së projekteve kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2025.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush diçka? Pasi që jo po votojmë.

Kush është të hyj në rend dite pika e parë e propozuar nga drejtori Agon Dreshaj, Destinimi i parcelës për varrezat e fshatit Zhakovë.

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë të hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

Kush është të hyj në rend dite pika e dytë e propozuar nga drejtori Abedin Kabashi, Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit, Pejë, Klinë,Istog, Deçan dhe Junik 2025-2035.

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë të hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

Kush është të hyj në rend dite pika e tretë e propozuar nga drejtori Genc Ademaj, Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së projekteve kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2025.

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë të hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

Kryesuesi i Kuvendit -hedh në votim kush është të hiqet nga rendi i ditës pika tre 'Shqyrtimi dhe miratimi Rregullores për Tregun tërë ditë në Istog?

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

Kryesuesi i Kuvendit- hedh në votim rendin e ditës në tërësi me propozimet e dhëna? Kush është të miratohet rendi i ditës për ditën e sotme?

Unanim miratohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

Prezent në mbledhje janë 7 anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Vendimet:

Miratohet unanim rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 1.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, vazhdojmë më pikën e parë të rendit të ditës' Shqyrtimi dhe miratim i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara. A ka dikush diçka rreth procesverbaleve?

Pasi që nuk ka diskutime.

Hedh në votim, kush është që të miratohen procesverbalet nga mbledhjet e kaluara?

Miratohen unanim procesverbalet nga mbledhjet e kaluara pa vërejtje.

Vendimet:

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 2.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova - vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës. Njoftimi me Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028,

Genc Ademaj- prezanton Njoftimin me Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin rreth kësaj pike. A e dëshiron dikush fjalën? Pasi që jo, hedh në votim pikën e rendit të ditës? Fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj-te kjo pjesa e transportit në nxënësve në nivel të përgjithshëm kjo vlerë a është vetëm për komunë të Istogut edhe për sa vite?

Genc Ademaj- për vitin 2026. Dhe jep sqarime të tjera.

Ajshe Metaj- mua më pelqeu ideja të granti i shëndetësisë për shkak se në komunën tonë kanë qen mungesë, është mjaftë e nevojshme. Te arsimit po shihet që ka mungesë të vendeve të punës, dhe nuk është fare e mirë, këto plus minus vlerën te granti i arsimit, i shëndetësisë dhe të hyrat vetanake a mundesh edhe një sqarim?

Genc Ademaj- përgjigjet dhe jep sqarime të nevojshme.

Kryesuesi i Kuvendit- a e ka edhe dikush diçka? Pasi që jo e hedh në votim kush është të shkoj për Kuvend?.

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë t'i kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim. Shtatë anëtarë prezent në mbledhje.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF - ja unanim ia kalon kuvendit të komunës Njoftimi me Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së Kornizë Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 3.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, vazhdojmë me pikën e tretë. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale. E hap debatin a ka dikush diçka? Pasi që jo e hedh në votim, kush është të shkoj për Kuvend?

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë t'i kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim dh miratim.

Shtatë anëtarë prezent në sallë.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës pikën rendit të ditës 'Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin Vendeve të Punës në Administratën Komunale.

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 4.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës. Destinimi parcelës për varrezat e fshatit Zhakovë. E hapi debatin. Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- desha vetëm me e ditë a kanë varreza më të vjetra, apo nuk ju mjafton ajo pjesë, apo kjo është diku tjetër apo është ngjitur për varreza.

Genc Ademaj- e kemi një problem profesorësh sepse parcela ku realisht ja kanë filluar me varrosje nu është parcelë e dedikuar për varreza.

Ajshe Metaj- e te varrezat e fshatit Kaliqan ajo rrethoja që është ndërtuar shumë nivel shumë mirë, a është ndërtuar nga buxheti komunal apo nga instanca tjera. Nëse është ndërtuar nga këtu , shumë mirë. dhe desh edhe diçka ata katrorët më të mëdhenj nuk i kishin kapakët dhe kur po bie shi po mbushen ujë. E pasi është bërë ky investim së paku edhe ato të rregullohen.

Genc Ademaj- ne e kemi ndërtuar rrugën e agjencioni e ka bërë rrethimin, por e ngritim si çështje at kapakët nuk e kanë ndonjë kosto të lartë.

Kryesuesi i Kuvendit- pasi nuk ka diskutime tjera e hedh në votim, kush është për?

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë t'i kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Shtatë anëtarë prezent në sallë.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim 'Destinimi i parcelës për varrezat e fshatit Zhakovë.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 5.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës. Plar Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit, Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik 2025-2035. Ajshe Metaj e ja fjalën.

Ajshe Metaj- a është për këtë menaxhim përgjegjëse komuna e Istogut?

Kryesuesi i Kuvendit- ne jem përgjegjës për komunën tonë. Me qenë një marrëveshje e pesë komunave të regjionit. Bashkëpunojmë mes vete. A ka edhe dikush diçka? E hedh në votim. Faruk Kabashi.

Faruk Kabashi- nuk e di çfarë të diskutojmë këtu, më shumë pika po na vijnë në mbledhje se sa në email. Nuk e di se si funksiononi.

Kryesuesi i Kuvendit- ne e dhamë arsyetimin, që kjo ka ardhur para dy dite. Vërtetë ki të drejtë.

Genc Ademaj- ne pikat i propozojmë nëse ju intereson i votoni, nëse jo jo. Kjo është punë që kërko përgjegjësi edhe nga ana e juve si Komitet që të kalojnë në Kuvend. Nuk kam faj unë që Qarkorja Buxhetor është lëshuar me vonesë po e them kushtimisht. Kërkojmë mirëkuptim, nuk është mungesë e komunikimit por janë procedura se as ne lehtë nuk e kemi.

Kryesuesi i Kuvendit- a e dëshiron edhe dikush tjetër fjalën. Pasi që jo, e hedh në votim, kush është për?

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë t'i kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Shtatë anëtarë prezent në sallë.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës 'Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit, Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik 2025-2035.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 6.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e gjashtë të rendit të ditës. 'Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së projekteve kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2025.

Genc Ademaj- prezanton pikën e rendit të ditës 'Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së projekteve kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2025.

Kryesuesi i Kuvendit- a e dëshiron edhe dikush tjetër fjalën. Pasi që jo, e hedh në votim, kush është për?

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë t'i kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Shtatë anëtarë prezent në sallë.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim 'Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së projekteve kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2025.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë. Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj :

11: 00.

Procesmbajtëse,
Znj. Flora Bujupaj



Kryesuesi i Kuvendit,
z. Enver Rugova

